



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

V E N D I M
K.P.P. 332/2021

Komisioni i Prokurimit Publik, i përbërë nga:

Jonaid Myzyri	Kryetar
Fiorent Zguro	Anëtar
Kreshnik Ternova	Anëtar
Anila Malaj	Anëtar

Në mbledhjen e datës 02.07.2021 shqyrtoi ankesën përkatësisht me:

- Objekt:** “Shfuqizim i vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave në lidhje me skualifikimin e ofertës së operatorit ekonomik “Iliria/D” SHPK në procedurën e prokurimit “*Procedurë e hapur*”, me nr. REF-92414-04-072021, me objekt “*Blerje materiale ndërtimi*”, me fond limit 9.491.753 (pa TVSH), zhvilluar në datën 04.05.2021, nga autoriteti kontraktor, Bashkia Finiq.
- Ankimues:** “Iliria/D” ShPK.
Lagja Nr.2, Rruga “Telat Noga”, Sarandë
- Autoriteti Kontraktor:** Bashkia Finiq
9716, Finiq, Vlorë
- Subjekte të interesuar:** “Kalivioti” ShPK.
Livadhja, nr.kadastral 2473 dhe nr.pasurie 20/1,20/2.20/3.20/4 dhe 20/5, Godina nr.1, Kati i parë, Vlorë
- Baza Ligjore:** Ligji nr. 9643, datë 20.11.2006 “*Për Prokurimin Publik*”, i ndryshuar, neni 19/1 e vijues, Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 914, datë 29.12.2014 “*Për miratimin e rregullave të prokurimit publik*”, i ndryshuar, Vendimi i Komisionit të Prokurimit Publik nr. 596/2018, datë 12.09.2018 “*Për miratimin e rregullave “Për Organizimin dhe Funksonimin e Komisionit të Prokurimit Publik*”, Neni 4 Vendimi i Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë

5.11.2020 “Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin e Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID -19”.

Komisioni i Prokurimit Publik, pasi dëgjoi relatorin e çështjes, shqyrtoi parashtrimet me shkrim të ankimuesit, dokumentacionin e paraqitur nga autoriteti, pretendimet e ankimuesit, dhe pasi diskutoi çështjen në tërësi,

Vëren:

I

Vlerësimi paraprak

I.1. Nga verifikimi paraprak i kësaj procedure prokurimi në SPE, konstatohet se, “Urdhri i Prokurimit” për këtë procedurë është publikuar në datë 23.03.2021, pra përpara datës së hyrjes në fuqi të Ligjit Nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, kështu që rrjedhimisht referuar nenit 134 pika 1 të ligjit të ri për prokurimin publik, ligji i zbatueshëm do të jetë Ligji nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar.

I.2. Pas shqyrtimit paraprak të ankesës të mbështetur në dokumentacionin e dërguar nga operatori ekonomik ankimues, Komisioni i Prokurimit Publik konstatoi se ky i fundit ka *prima facie* interes në këtë procedurë prokurimi dhe për këtë arsye legjitimohet për të paraqitur ankesë në lidhje me të, bazuar në pikën 1 të nenit 63 të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar;

I.3. Operatori ekonomik ka paraqitur fillimisht ankesë pranë autoritetit kontraktor, dhe më pas ka paraqitur ankesë, pranë Komisionit të Prokurimit Publik, si organi më i lartë në fushën e prokurimeve, që shqyrton ankesat për procedurat e prokurimit, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar;

I.4. Ka respektuar afatet ligjore të paraqitjes së ankesës pranë autoritetit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik;

Në këto kushte Komisioni i Prokurimit Publik mori në shqyrtim në themel objektin e ankesës së operatorit ekonomik ankimues.

II

Rrethanat e çështjes

II.1. Në datën 08.04.2021, është publikuar nga autoriteti kontraktor, në faqen e internetit të Agjencisë së Prokurimit Publik, procedura e prokurimit “Procedurë e hapur”, me nr. REF-92414-

04-072021, me objekt “Blerje materiale ndërtimi”, me fond limit 9.491.753 (pa TVSH), zhvilluar në datën 04.05.2021, nga autoriteti kontraktor, Bashkia Finiq.

II.2. Në datën 04.05.2021, autoriteti kontraktor ka zhvilluar procedurën e prokurimit.

II.3. Nga verifikimi në sistemin e prokurimit elektronik (SPE) si dhe referuar informacionit të autoritetit kontraktor të dorëzuar pranë Komisionit të Prokurimit Publik, autoriteti kontraktor në datë 21.05.2021 ka kryer vlerësimin e ofertave të operatorëve ekonomikë pjesëmarrës në këtë procedurë prokurimi të cilët kanë paraqitur ofertat ekonomike (pa TVSH), përkatësisht:

1. “Iliria/D” SHPK	8.847.795 lekë, skualifikuar
2. “Jody Kompany” SHPK	9.058.860 lekë, skualifikuar
3. “Kalivioti” SHPK	9.167.725 lekë, kualifikuar
4. “Dinamika” SHPK	9.491.750 lekë, kualifikuar

II.4. Në datën 21.05.2021 operatori ekonomik “Iliria/D” SHPK është njoftuar elektronikisht për klasifikimin e ofertave si dhe skualifikimin e tij në këtë procedurë prokurimi me arsyetimin si më poshtë:

Operatori Ekonomik nuk permbush piken 2.3.1 te kapacitetit teknik per furnizimet e mëparshme të ngjashme të kryera gjatë 3 (tre) viteve të fundit, në vlerën prej 40% të fondit limit të venë në dispozicion ose e shprehur ne vlere shuma prej 3 796 701 Leke pa TVSh. Operatori Ekonomik ka paraqitur eksperiencia te meparshme ne zerin pune me objekt “Rikonstruksion rruge te brendshme ne fshatin Gjashte” me vlefte 5.040.020 , dhe zerin mallra “Blerje materiale ndertimi (inerte)” me vlefte 2.916.667 leke. Prej ketyre dy eksperiencave pranohet vetem ajo per furnizimin me mallra, konkretisht “Blerje materiale ndertimi (inerte)” me vlefte 2.916.667 leke e cila eshte e njejte me objektin e prokurimit por vlefte e saj nuk perkon (pasi eshte me e ulet) me vlefte e kerkuar qe eshte 3.796.701 leke .

II.5. Në datën 24.05.2021 operatori ekonomik “Iliria/D” SHPK ka paraqitur ankesë pranë autoritetit kontraktor duke kundërshtuar skualifikimin e ofertës së tij ekonomike , me arsyetimin si më poshtë vijon:

[...]

Duke ju referuar DST ju kërkoni furnizimin midis materialeve të tjera dhe furnizim me materiale inerte si cakell makinerie, cakell mbeturine, zgara hekuri dhe betoni i gatshëm C20/25 të cilat do të transportohen në vepër me mjetet e operatorit ekonomik (për këtë qëllim janë kërkuar mjetet e nevojshme).

Nga ana jonë janë paraqitur si eksperiencë të mëparshme dy objekte:

- 1. Rikonstruksion rruge të brendshme në fshatin Gjashtë.*
- 2. Blerje materiale ndërtimi (Inerte)*

Në eksperiencën e parë të paraqitur përfshihen punimet e mëposhtme:

- a. Shtresë stabilizant t=12 cm*
- b. Struktura monolite betoni C 20/25 t=12 cm*
- c. F.V hekur betoni në b/arme 20 x 20 Ø ~ 5 mm*

Duke ju referuar Vendimit Nr.629, datë 15.7.2015 Për miratimin e manualeve teknike të çmimeve të punimeve të ndërtimit dhe të analizave teknike të tyre Elementët e kostos për çdo zë punimesh janë:

Material, Punëtori, Makineri, Transport.

Ju në procedurën tuaj kërkon furnizimin me material në objekt, çdo zë punimesh i paraqitur në eksperiencën tonë të ngjashme në vetvete e përmban atë që kërkon në DST. Pra Cakëll, Zgara hekuri dhe Beton C20/25.

Eksperiencat tona janë konform ligjit dhe në përputhje me DST.

Për arsyet e përmendura më sipër si dhe për faktin se oferta jonë është më e ulët në një vlerë prej 383.916 lekë kërkojmë që oferta jonë ekonomike të mos skualifikohet por të shpallet e vlefshme, pasi gjithashtu jeni duke i shkaktuar një dëm ekonomik edhe shtetit duke shpallur fitues një kompani e cila ka ofertë më të lartë krahasimisht me tonën. Kërkojmë nga autoriteti kontraktues të verifikoj me kujdes plotësimin e këtij kriteri dhe të ndryshoj vendimin e marrë në datë 21.05.2021.

II.6. Autoriteti kontraktor me anë të shkresës nr.1396 prot., datë 27.05.2021, i ka kthyer përgjigje ankesës së operatorit ekonomik ankimues duke e refuzuar atë, me argumentin si më poshtë:

[...]

Duke parë ankesën e operatorit ekonomik "Iliria/D" sh.p.k. dhe përputhshmërinë e saj me parashikimet e Ligjit Nr. 162/2020, 23/12/2020 "Për prokurimin publik", Kreu XIV "Ankimimi administrativ", komisioni vëren se:

1. Ankesa i është drejtuar vetëm autoritetit kontraktor Bashkia Finiq në kundërshtim me Nenin 111 "Paraqitja e ankesës", pika 1 ku citohet "Operatori ekonomik ankimues dërgon njëkohësisht ankesën në autoritetin kontraktor dhe Komisionin e Prokurimit Publik".

2. Operatori "Iliria/D" ShPK nuk i ka bashkëlidhur ankesës dokumentin bankar që vërteton pagesën e tarifës përkatëse për ankesën, në kundërshtim me Nenin 111 "Paraqitja e ankesës" pika 2 ku citohet: "Ankesa bëhet sipas formularit përkatës, ku shënohen emri dhe adresa e ankuesit, referimi për procedurën konkrete dhe bazën ligjore, ku ankuesi pretendon për shkeljet, pagesa e tarifës së ankesës, duke e shoqëruar atë me dokumentacionin dhe provat përkatëse, për të cilat mendon se mbështesin ankimin e tij. Elementet e sipërpërmendura janë të domosdoshme për shqyrtimin e ankesës. Ankuesi është i detyruar t'i bashkëlidhë ankimit dokumentin bankar që vërteton pagesën e tarifës përkatëse për ankesën."

3. Nga verifikimi në databazën e Komisionit të Prokurimit Publik, komisioni verifikoi se kjo ankesë nuk është paraqitur pranë këtij institucioni, në kundërshtim me Nenin 112 "Veprimet paraprake", pika 1 ku citohet "Me marrjen e ankesës, autoriteti ose enti kontraktor konfirmon në databazën e të dhënave të publikuara nga Komisioni i Prokurimit Publik që ankesa është paraqitur pranë këtij institucioni. Nëse autoriteti ose enti kontraktor konstaton se ankesa nuk është paraqitur në Komisionin e Prokurimit Publik, e refuzon atë si të pavlefshme."

Sa më lart Komisioni i Shqyrtimit të Ankesave mbështetur në Ligjin Nr. 162/2020, 23/12/2020, "Për prokurimin publik", Kreu XIV "Ankimimi administrativ", Neni 111, pika 1 dhe 2, si dhe neni 112, pika 1, refuzon si të pavlefshme ankesën e operatorit ekonomik "Iliria/D" ShPK për vlerësimin e ofertave të procedurës së prokurimit me objekt "Blerje materiale ndërtimi", me fond limit 9.491.753 lekë pa TVSh.

II.7. Në datën 31.05.2021 operatori ekonomik “Iliria/D” SHPK ka paraqitur ankesë në Komisionin e Prokurimit Publik duke kundërshtuar skualifikimin e ofertës së tij ekonomike me pretendimet si më poshtë:

[...]

Po ju sqarojmë se: Për të plotësuar këtë kriter ne jemi mbështetur në pikën a për furnizime me ente publike dhe konkretisht kemi paraqitur dy eksperiencë 1. “Blerje material ndërtimi inerte me vleftë 2.916.667 lekë” dhe 2. “Rikonstruksion rruge të brendshme në fshatin Gjashtë” me vlerë 5.040.020 lekë, ku e para përmban në vetvete furnizim me materiale të ndryshme ndërtimi si çimento, inerte, gëlqere, etj. dhe e dyta shtrim ne beton të rrugëve të brendshme të fshatit Gjashtë. Nga ana e autoritetit kontraktor eksperiencë e paraqitur në zërin punë “Rikonstruksion rruge të brendshme në fshatin Gjashtë” nuk është marrë parasysh. Duke ju referuar DST kërkohet midis materialeve të tjera dhe furnizim me materiale inerte si çakull makinerie, çakull mbeturine, zgara hekuri dhe Beton i gatshëm C20/25 të cilat do të transportohen në vepër me mjetet e operatorit ekonomik, (për këtë qëllim janë kërkuar mjetet e nevojshme).

Në eksperiencën e dytë të paraqitur nga ana jonë përfshihen punimet e mëposhtme:

a. Shtresë stabilizant $t=12$ cm

b. Struktura monolite betoni C 20/25 $t=12$ cm

c. F.V hekur betoni në b/arme 20 x 20 $\varnothing \sim 5$ mm

Duke ju referuar Vendimit Nr.629, datë 15.7.2015 Për miratimin e manualeve teknike të çmimeve të punimeve të ndërtimit dhe të analizave teknike të tyre Elementët e kostos për çdo zë punimesh janë:

Material,

Punëtori,

Makineri,

Transport.

Në DST kërkohet furnizimi me material në objekt, në specifikimet teknike përcaktohet qartë se Beton i gatshëm C20/25 do të përdoret për shtresa në rrugë e Furnizimin me materialet si Çakëll, Zgara hekuri dhe Beton C 20/25 duke përfshirë dhe hedhjen me betoniere të betonit në vepër, eksperiencë e paraqitur nga ana jonë “Rikonstruksion rruge të brendshme në fshatin Gjashtë” është e njëjtë me atë të specifikimeve teknike.

Kjo eksperiencë konkretisht përmban:

1. Shtrese stabilizant 15 cm, ne vleftë 1.680.200 leke, ku nga zbërthimi i analizës së zërit të punimeve vlera e materialit së bashku me transportin është 56 % e vlerës ose 940.912 lekë.

2. Struktura monolite betoni C20/25 $t=12$ cm me vleftë 2.719.500 lekë, ku nga zbërthimi i analizës së zërit të punimeve vlera e materialit së bashku me transportin është 60 % e vlerës ose 1.631.700 lekë.

3. F.V Hekur betoni në b/a 20x20 cm $\varnothing 3 \sim 5$ mm me vleftë 135000 lekë, ku është tërësisht i ngjashëm me eksperiencën që kërkohet.

Duke u mbështetur në analizën e mësipërme mendojmë se te gjitha zërat e paraqitur nga ana jonë plotësojnë kushtin si eksperiencë e ngjashme, i vetmi ndryshim është që në këto zëra përfshihet dhe punëtorja e cila do të realizohet nga autoriteti kontraktor. (Betonit nuk do të depozitohet në magazinë, do të kryhet furnizimi me mjetet tona (autobetoniere) në objektin e përcaktuar nga

autoriteti kontraktor dhe përpunimi do të bëhet nga autoriteti kontraktor me specialistët e tij. Në përfundim të analizës jemi të bindur se:

Eksperiencia “Rikonstruksion rruge të brendshme në fshatin Gjashtë” e paraqitur në ofertën tonë është konform ligjit dhe në përputhje me DST. Për arsyet e përmendura më sipër si dhe për faktin se oferta jonë është më e ulët në një vlerë prej 383.916 lekë kërkojmë që oferta jonë ekonomike të shpallet e vlefshme, pasi gjithashtu i shkaktohet shtetit një dëm ekonomik duke shpallur fitues një kompani e cila ka ofertë më të lartë krahasimisht me tonën.

II.8. Nëpërmjet shkresës nr. 1527/2 prot., datë 11.06.2021, protokolluar me tonën në datën 18.06.2021, është depozituar në Komisionin e Prokurimit Publik informacioni i autoritetit kontraktor lidhur me procedurën e mësipërme të prokurimit dhe trajtimin e ankesës së operatorit ekonomik ankimues.

III

Komisioni i Prokurimit Publik

pas shqyrtimit të ankesës, dokumentacionit bashkëngjitur, si edhe informacionit dhe dokumentacionit të autoritetit kontraktor

Arsyeton

III.1. Lidhur me pretendimin e operatorit ekonomik “Iliria/D” ShPK, se arsyeja e skualifikimit “Operatori Ekonomik nuk përmbush piken 2.3.1 të kapacitetit teknik për furnizimet e mëparshme të ngjashme të kryera gjatë 3 (tre) viteve të fundit, në vlerën prej 40 % të fondit limit të venë në dispozicion ose e shprehur në vlerë shuma prej 3 796 701 Leke pa TVSh. Operatori Ekonomik ka paraqitur eksperiencë të mëparshme në zërin punë me objekt “Rikonstruksion rruge të brendshme në fshatin Gjashtë” me vlefte 5.040.020 , dhe zërin mallra “Blerje materiale ndërtimi (inerte)” me vlefte 2.916.667 lekë. Prej këtyre dy eksperiencave pranohet vetëm ajo për furnizimin me mallra, konkretisht “Blerje materiale ndërtimi (inerte)” me vlefte 2.916.667 lekë e cila është e njëjtë me objektin e prokurimit, por vlefte e saj nuk përkon (pasi është më e ulët) me vlefte të kërkuar që është 3.796.701 lekë”, nuk qëndron, Komisioni i Prokurimit Publik vëren se:

III.1.1. Në dokumentet e tenderit Shtojca 9, “Kriteret e Veçanta të Kualifikimit”, pika 2.3.1 “Kapaciteti teknik”, nga autoriteti kontraktor është përcaktuar kriteri:

Përvojë e suksesshme në ekzekutimin e të paktën:

Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për furnizimet e mëparshme të ngjashme të kryera gjatë 3 (tre) viteve të fundit, në vlerën prej 40% të vlerës së fondit limit të venë në dispozicion.

Këto furnizime të mëparshme, të ngjashme, duhet të vërtetohen me dokumentacionin si më poshtë:

a. Kur furnizimet e ngjashme janë realizuar me ent publik, operatori ekonomik duhet të paraqesë kontrata të nënshkruara, të cilat duhet të shoqërohen me vërtetim për realizimin me sukses të furnizimeve.

b. Kur furnizimet e ngjashme janë realizuar me subjekte private, operatori ekonomik duhet të paraqesë faturën përkatëse tatimore të shitjes ku të shënohen datat, shumat dhe sasishtë e mallrave të furnizuara.

Gjithashtu në shtojcën e publikuar nga autoriteti kontraktor për modifikimin e dokumenteve të tenderit kriteri i mësipërm është modifikuar si më poshtë:

IV. Pika 2.3.1 Kapaciteti teknik:

Ishte

1 Përvojë e suksesshme në ekzekutimin e të paktën:

Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për furnizimet e mëparshme të ngjashme të kryera gjatë 3 (tre) viteve të fundit, në vlerën prej 40% të vlerës së fondit limit të venë në dispozicion.

Behet

1 Përvojë e suksesshme në ekzekutimin e të paktën:

Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për furnizimet e mëparshme të ngjashme të kryera gjatë 3 (tre) viteve të fundit, në vlerën prej 40% të vlerës së fondit limit të venë në dispozicion ose e shprehur ne vlere shuma prej 3 796 701 Leke pa TVSh.

III.1.2. Në Shtojcën “Preventiv pa çmime” të publikuar nga autoriteti kontraktor është përcaktuar preventivi që duhet të paraqesin operatorët ekonomikë të interesuar, i cili përbëhet si më poshtë:

1. Rërë guri makinerie	m^3	50
2. Çakëll për betone (makinerie)	m^3	50
3. Çakëll mbeturine për mbushje	m^3	300
4. Beton i gatshëm C20/25, me çakëll, (në segm.rrugore	m^3	1065
5. Zgare hekuri Ø 4 mm për shtresa betoni në rrugë me permasa (4.7*2)m, kuadrati (25*25) cm	cope	1065
6. Çimento e zakonshme 42.5R	kg	3000
7. Tubo betoni Ø 600 mm	ml	24
8. Tubo betoni Ø 800 mm, t=10 cm	ml	25
9. Tubo betoni Ø 1000 mm, t=10 cm	ml	40
10. Lende e trashe pishe 5 cm e stazhionuar për çati të dukshme	m^3	10
11. Lende e holle e sharruar C II-III (3cm)	m^3	2
12. Lende druri importi e stazhionuar per çati te dukshme	m^3	1
13. Tavan rabote	m^2	25
14. Listela druri (40*40) mm te stazhionuar	ml	40
15. Listela druri (10*30) mm te stazhionuar	ml	30
16. Karton katrama = 4 mm importi	m^2	25
17. Tjegulla marsejeze importi	copë	300
18. Tjegulla kulmi importi	ml	12
19. Fiksuese metalike kendore (10*10) cm	copë	20
20. Gozhdë ndërtimi 6, 8, 10 cm	kg	50
21. Vida druri 8, 10 cm	copë	1000
22. Bordura betoni (15*35) cm	ml	50
23. Hekur betoni periodik Ø > 12mm	kg	80
24. Hekur betoni periodik 6 ÷12 mm	kg	80

25. Tel bari	kg	15
26. Elektroda skadimi	kg	80
27. Blloqe betoni me vrima (20*20*40) cm	copë	700
28. Tulla me 6 vrima për mure ndarës	copë	1000
29. Hekur profil (“L”, “U” e kuadrat) dhe shirit	kg	1500
30. Bojë vaji	kg	75
31. Bojë antiruxho	kg	85
32. Vaj për sharrë prerje metali	litra	8
33. Neft për shkrirjen e bojës antiruxho	litra	70
34. Bojë bikomponente për vijëzim rrugësh	kg	25
35. Disqe për prerje metali	copë	45
36. Disqe për kruarje metali të vogla (axhustim)	copë	30
37. Tabela treguese (60*20) cm për “Taksi”	copë	8
38. Tabela rrugore D=60 cm	copë	6
39. Gëlqere e shuar qull në qeska	kg	500
40. Lllamarinë xingato = 1.5mm	kg	100

III.1.3. Nga shqyrtimi i dokumentacionit të operatorit ekonomik “Iliria/D” ShPK në përmbushje të kriterit të mësipërm rezulton se është paraqitur dokumentacioni si më poshtë vijon:

- Kontratë nr. 2 prot., e lidhur në datën 07.09.2020, me objekt “Blerje materiale ndërtimi (Inerte)”, me vlerë 2 916 667 lekë pa TVSh, midis operatorit ekonomik “Iliria/D” ShPK dhe autoritetit kontraktor Ndërmarrja e Shërbimeve Publike Sarandë.
- Vërtetim Nr. 04 prot., datë 08.04.2021 për realizimin me sukses të kontratës, lëshuar nga autoriteti kontraktor Ndërmarrja e Shërbimeve Publike Sarandë
- Fatura tatimore
- Kontratë nr. 22 prot., e lidhur në datën 24.09.2018 me, me objekt “Rrugë të brendshme me beton dhe ndriçim në fshatin Gjashtë”, me vlerë 6 048 024 lekë me TVSh, midis operatorit ekonomik “Iliria/D” ShPK dhe autoritetit kontraktor Bashkia Sarandë.
- Formular Vlerësimi për kryerjen me sukses të punimeve
- Akt kolaudimi datë 23.10.2018
- Situacion punimesh (përfundimtar)
- Certifikatë e marrjes përfundimtare në dorëzim të punimeve nga autoriteti kontraktor
- Faturë tatimore shitjeje nr.25 datë 23.10.2018

III.1.4. Në nenin 46, pika 1/b të Ligjit Nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, parashikohet se: “Operatorët ekonomikë, për të marrë pjesë në procedurat e prokurimit, duhet të kualifikohen, pasi të kenë përmbushur të gjitha kriteret që autoriteti kontraktor i vlerëson të nevojshme, për sa kohë që ato janë në përpjesëtim me natyrën dhe përmasat e kontratës që do të prokurohen dhe jodiskriminuese

b) aftësia teknike: operatorët ekonomikë vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, për të zbatuar kontratën, siç është përshkruar nga autoriteti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës;”

III.1.5. Në nenin 53, pika 3 të Ligjit Nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, parashikohet se: “Autoriteti kontraktor, në zbatim të pikës 4 të këtij neni, vlerëson një ofertë të vlefshme, vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentet e tenderit...”.

III.1.6. Në nenin 27 pika 4 të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, parashikohet:

“4.Për të provuar përvojën e mëparshme, autoriteti kontraktor kërkon dëshmi për furnizimet e mëparshme, të ngjashme, të kryera gjatë tri viteve të fundit. Në çdo rast, vlera e kërkuar duhet të jetë në një vlerë jo më të madhe se 40% të vlerës së përlogaritur të kontratës, që prokurohet dhe që është realizuar gjatë tri viteve të fundit.

Autoriteti kontraktor si dëshmi për përvojën e mëparshme kërkon vërtetime të lëshuara nga një ent publik ose/dhe fatura tatimore të shitjes, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.

Në rastin e përvojës së mëparshme të realizuar me sektorin privat, si dëshmi pranohen vetëm fatura tatimore të shitjes, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.”

III.1.7. Operatori ekonomik ankimes pretendon: Po ju sqarojmë se: Për të plotësuar këtë kriter ne jemi mbështetur në pikën a për furnizime me ente publike dhe konkretisht kemi paraqitur dy eksperiencat 1. “Blerje material ndërtimi inerte me vlefë 2.916.667 lekë” dhe 2. “Rikonstrukcion rrugë të brendshme në fshatin Gjashtë” me vlerë 5.040.020 lekë, ku e para përmban në vetvete furnizim me materiale të ndryshme ndërtimi si çimento, inert, gëlqere, etj. dhe e dyta shtrim beton të rrugëve të brendshme të fshatit Gjashtë. Nga ana e autoritetit kontraktor eksperiencat e paraqitura në zërin punë “Rikonstrukcion rrugë të brendshme në fshatin Gjashtë” nuk është marrë parasysh. Duke ju referuar DST kërkohet midis materialeve të tjera dhe furnizim me materiale inerte si çakull makinerie, çakull mbeturine, zgara hekuri dhe Beton i gatshëm C20/25 të cilat do të transportohen në vepër me mjetet e operatorit ekonomik, (për këtë qëllim janë kërkuar mjetet e nevojshme).

Në eksperiencën e dytë të paraqitur nga ana jonë përfshihen punimet e mëposhtme:

a. Shtresë stabilizant $t=12$ cm

b. Struktura monolite betoni C 20/25 $t=12$ cm

c. F.V hekur betoni në b/arme 20 x 20 Ø ~ 5 mm

Duke ju referuar Vendimit Nr.629, datë 15.7.2015 Për miratimin e manualeve teknike të çmimeve të punimeve të ndërtimit dhe të analizave teknike të tyre Elementët e kostos për çdo zë punimesh janë:

Material,

Punëtori,

Makineri,

Transport.

Në DST kërkohet furnizimi me material në objekt, në specifikimet teknike përcaktohet qartë se Beton i gatshëm C20/25 do të përdoret për shtresa në rrugë e Furnizimin me materialet si Çakull, Zgara hekuri dhe Beton C 20/25 duke përfshirë dhe hedhjen me betoniere të betonit në vepër, eksperiencat e paraqitura nga ana jonë “Rikonstrukcion rrugë të brendshme në fshatin Gjashtë” është e njëjtë me atë të specifikimeve teknike.

Kjo eksperiencë konkretisht përmban:

1. Shtrese stabilizant 15 cm, ne vleftë 1.680.200 leke, ku nga zberthimi i analizës së zërit të punimeve vlera e materialit së bashku me transportin është 56 % e vlerës ose 940.912 lekë.
2. Struktura monolite betoni C20/25 t=12 cm me vleftë 2.719.500 lekë, ku nga zberthimi i analizës së zërit të punimeve vlera e materialit së bashku me transportin është 60 % e vlerës ose 1.631.700 lekë.
3. F.V Hekur betoni në b/a 20x20 cm Ø 3 ~5 mm me vleftë 135000 lekë, ku është tërësisht i ngjashëm me eksperiencën që kërkohet.

Duke u mbështetur në analizën e mësipërme mendojmë se te gjitha zërat e paraqitur nga ana jonë plotësojnë kushtin si eksperiencë e ngjashme, i vetmi ndryshim është që në këto zëra përfshihet dhe punëtorja e cila do të realizohet nga autoriteti kontraktor. (Betoni nuk do të depozitohet në magazinë, do të kryhet furnizimi me mjetet tona (autobetoniere) në objektin e përcaktuar nga autoriteti kontraktor dhe përpunimi do të bëhet nga autoriteti kontraktor me specialistët e tij. Në përfundim të analizës jemi të bindur se:

Eksperienca “Rikonstruksion rruge të brendshme në fshatin Gjashtë” e paraqitur në ofertën tonë është konform ligjit dhe në përputhje me DST. Për arsyet e përmendura më sipër si dhe për faktin se oferta jonë është më e ulët në një vlerë prej 383.916 lekë kërkojmë që oferta jonë ekonomike të shpallet e vlefshme, pasi gjithashtu i shkaktohet shtetit një dëm ekonomik duke shpallur fitues një kompani e cila ka ofertë më të lartë krahasimisht me tonën.. [...]

III.1.8. Nga shqyrtimi i dokumenteve të tenderit si dhe shtojcës së publikuar nga autoriteti kontraktor për modifikimin e tyre, KPP vëren se, autoriteti kontraktor në kriteret e veçanta të kualifikimit, për kapacitetin teknik ka kërkuar shprehimisht që ”Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për furnizimet e mëparshme të ngjashme të kryera gjatë 3 (tre) viteve të fundit, në vlerën prej 40 % të vlerës së fondit limit të venë në dispozicion ose e shprehur në vlerë shuma prej 3 796 701 Leke pa TVSh. a. Kur furnizimet e ngjashme janë realizuar me ent publik, operatori ekonomik duhet të paraqesë kontrata të nënshkruara, të cilat duhet të shoqërohen me vërtetim për realizimin me sukses të furnizimeve.

b. Kur furnizimet e ngjashme janë realizuar me subjekte private, operatori ekonomik duhet të paraqesë faturën përkatëse tatimore të shitjes ku të shënohen datat, shumat dhe sasinë e mallrave të furnizuara.”.

Sa më sipër, referuar kriterit të përcaktuar nga autoriteti kontraktor për sa i përket kontratave të ngjashme, si dhe nga shqyrtimi i dokumentacionit të paraqitur nga operatori ekonomik “Iliria/D” ShPK, konstatojmë se ky i fundit në përmbushje të kriterit të mësipërm ka paraqitur Kontratën nr. 2 prot., e lidhur në datën 07.09.2020, me objekt “Blerje materiale ndërtimi (Inerte)”, me vlerë 2 916 667 lekë pa TVSh, midis operatorit ekonomik “Iliria/D” ShPK dhe autoritetit kontraktor Ndërmarrja e Shërbimeve Publike Sarandë, shoqëruar me Vërtetim për realizimin me sukses të kontratës, lëshuar nga autoriteti kontraktor si dhe fatura tatimore. Gjithashtu operatori ekonomik ankimes ka paraqitur Kontratën nr. 22 prot., e lidhur në datën 24.09.2018, me objekt “Rrugë të brendshme me beton dhe ndriçim në fshatin Gjashtë”, me vlerë 6 048 024 lekë me TVSh, midis operatorit ekonomik “Iliria/D” sh.p.k. dhe autoritetit kontraktor Bashkia Sarandë, shoqëruar me Formular Vlerësimi për kryerjen me sukses të punimeve, Akt kolaudimi, Situacion punimesh (përfundimtar), Certifikatë e marrjes përfundimtare në dorëzim të punimeve nga autoriteti kontraktor si dhe Faturë tatimore shitjeje nr.25 datë 23.10.2018.

III.1.9. Nga verifikimi i kontratave të mësipërme të paraqitura si dëshmi për eksperiencat e mëparshme të ngjashme, konstatohet se referuar zërave të këtyre kontratave operatori ekonomik

ankimues ka kryer furnizime të ngjashme, me zërat e parashikuar nga autoritetit kontraktor në preventivin e publikuar për procedurën e prokurimit objekt shqyrtimi.

III.1.10. Sa më sipër, KPP gjykon se, kriteret për kualifikim i shërbejnë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorëve ekonomikë, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës. Në këtë kuptim, për autoritetin kontraktor është e rëndësishme të provohet që operatori ekonomik zotëron eksperiencat e mëparshme të ngjashme me objektin e prokurimi por, edhe në përputhje me volumin e përcaktuar në dokumentet e tenderit.

Nisur nga arsyeja e skualifikimit, KPP gjykon se, autoriteti kontraktor nuk duhet të gjykojë në mënyrë sipërfaqësore e formale, por të analizojë në themel dhe në mënyrë të arsyeshme e proporcionale eksperiencat e dokumentuara nga ofertuesit/kandidatët, në funksion të qëllimit dhe rrethanave faktike për të cilin vendosen kriteret e përcaktuara. Sa më sipër, KPP, konstaton se, me dokumentacionin e paraqitur, operatori ekonomik ankimues ka plotësuar kriterin e vendosur nga autoriteti kontraktor në shtojcën 9, pika 2.3.1 “Për Kapaciteti teknik” të dokumenteve të tenderit për sa i përket eksperiencën e ngjashme. KPP gjykon se për të plotësuar pikën e mësipërme të kërkesave për kualifikim për eksperiencën e ngjashme, operatorët ekonomik duhet të paraqesin kontrata të ngjashme me objektin që prokurohet dhe jo kontrata identike, pasi për autoritetin kontraktor është e rëndësishme të provohet që operatori ekonomik zotëron eksperiencat e mëparshme të ngjashme me objektin e prokurimi por, edhe në përputhje me volumin e përcaktuar në dokumentet e tenderit. Gjithashtu vlen të theksohet se vlera e përgjithshme e zërave të ngjashëm të realizuara në dokumentet e paraqitura nga ky operator ekonomik, e tejkalon vlerën prej 40 % të vlerës së fondit limit, për furnizime të mëparshme të ngjashme të realizuara gjatë tri viteve të fundit.

Nga verifikimi i zërave dhe volumeve të ngjashme të preventivit të kontratave të paraqitura nga ankimuesi si kontrata të ngjashme të mëparshme, nga përlllogaritja e zërave të ngjashëm për sa i përket llojit, tipologjisë, emërimit/përshkrimit, me zërat e preventivit të kontratës objekt shqyrtimi, rezulton se operatori ekonomik ankimues ka arritur të dëshmojë se ka kryer furnizime të mëparshme të ngjashme me objektin e prokurimit në vlerën e përcaktuar nga autoriteti kontraktor në dokumentet e tenderit, pasi zërat e konsideruar të ngjashëm përmbushin vlerën prej 3.796.701 lekë pa TVSh, sipas kërkesave të autoritetit kontraktor.

III.1.11. Nisur nga sa më lart, Komisioni i Prokurimit Publik, gjykon se dokumentacioni i paraqitur nga operatori ekonomik ankimues, për të vërtetuar eksperiencën e mëparshme, është në përputhje me kërkesat e autoritetit kontraktor.

Kriteret për kualifikim vendosen që t'i shërbejnë autoritetit kontraktor për të krijuar një panoramë të përgjithshme të kapaciteteve dhe mundësisë së operatorit për përmbushje me sukses të kontratës. Operatorët ekonomikë pjesëmarrës duhet të vërtetojnë se zotërojnë reputacionin, besueshmërinë dhe përvojën e duhur, për të zbatuar kontratën objekt prokurimi, si edhe janë të detyruar të përgatisin oferta, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në dokumentet e tenderit, në mënyrë që edhe vlerësimi të bëhet në përputhje me këtë dokumentacion.

Autoriteti kontraktor do të konsiderojë një ofertë të vlefshme, vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentet e tenderit. Në rastin konkret, Komisioni i Prokurimit Publik vlerëson se kontratat e paraqitura nga

operatori ekonomik ankimes në procedurën e prokurimit, plotësojnë kërkesat e përcaktuara nga autoriteti kontraktor në dokumentet e tenderit. Në këto kushte, KPP gjykon se operatori ekonomik ankimes e ka përmbushur kriterin e vendosur nga autoriteti kontraktor për sa i përket eksperiencës së mëparshme të ngjashme.

Prërdhimisht, pretendimi i operatorit ekonomik “Iliria/D” ShPK qëndron.

Për sa më sipër, në mbështetje të nenit 19/1 dhe vijues, të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, nenit 31 të Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 596/2018, datë 12.09.2018 “Për miratimin e rregullave “Për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, nenit 4 të Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë 5.11.2020 “Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin e Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID -19”, Komisioni i Prokurimit Publik njëzëri,

Vendos

1. Të pranojë ankesën e operatorit ekonomik “Iliria/D” SHPK për procedurën e prokurimit “Procedurë e hapur”, me nr. REF-92414-04-072021, me objekt “Blerje materiale ndërtimi”, me fond limit 9.491.753 (pa TVSH), zhvilluar në datën 04.05.2021, nga autoriteti kontraktor, Bashkia Finiq.
2. Autoriteti kontraktor të anulojë vendimin e KVO-së për skualifikimin e operatorit ekonomik “Iliria/D” SHPK dhe të korrigjojë shkeljet e konstatuara, duke e kualifikuar këtë operator ekonomik.
3. Autoriteti kontraktor, brenda 10 ditëve, të vërë në dijeni Komisionin e Prokurimit Publik për zbatimin e vendimit, duke dokumentuar veprimet e kryera.
4. Kundër këtij vendimi, mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë, Tiranë.
5. Ngarkohet zyra e financës të bëjë kthimin e tarifës financiare të paguar nga operatori ekonomik “Iliria/D” ShPK.
6. Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Nr. 945 Protokolli

Datë 31.05.2021

KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Nënkryetar
Fiorent Zguro

Anëtar
Kreshnik Ternova

Anëtar
Anila Malaj

Kryetar
Jonaïd Myzyri